



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN  
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 5342/2 prot.

Laç, më 21.12.2023

VENDIM

Nr. 34, datë 23 / 11.2023

**“PËR MOS MIRATIMIN E LIBERALIZIMIT TË TARIFAVE TË UJIT TË PIJSHËM,  
GRUMBULLIMIT E LARGIMIT TË UJRAVE TË NDOTURA.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ligjit nr.8102, date 28.03.1996 “Për kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura” të ndryshuar, të Vendimit nr.539, date 30.12.2021 “Per miratimin e metodologjise dhe procedurës per miratimin e tarifave te shërbimeve Ujësjelles Kanalizime”, të Marrëveshjes për Krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës Kanalizimeve, si dhe në shkresën e Shoqerisë Rajonale Ujësjelles Kanalizime Lezhë Sh.a nr.890 prot. datë 15.09.2023 “Kërkesë”, pas propozimit nga Kryetarja e Bashkisë ,Këshilli Bashkiak :

VENDOSI :

1. Shqyrtimin dhe dhënien e mendimit kundër për planin tarifor të Shoqerise Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhe Sh.a, Njesia e Shërbimit Sh.a Ujësjellës Kanalizime Kurbin.
2. Per zbatimin e ketij Vendimi dhe ndjekjen e procedurave ngarkohet Shoqeria Rajonale Ujësjelles Kanalizime Lezhe Sh.a, Njesia e Shërbimit Sh.a Ujësjellës Kanalizime Kurbin dhe Bashkia Kurbin.

Ky vendim hyn në fuqi 10( dhjetë) ditë pas shpalljes .

- > Prefektit Qarkut Lezhe
- > Drejtoria e Sherbimeve Publike
- > Arkivi

SEKRETAR I KESHILLIT  
Arber LEKA

KRYETARE E KESHILLIT  
Edlira LLESHI

